

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"BUSINESS ACCOUNTING GROUP" SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"BUSINESS ACCOUNTING GROUP" Sh.p.k.**

**1- MIMOZA MURATI** atesia **PELLUMB**, shtetase SHQIPETARE, lindur me 16.04.1987 ne SKRAPAR, identifikohet nepermjet pasaportes 175416072V.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **"BUSINESS ACCOUNTING GROUP" Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **"BUSINESS ACCOUNTING GROUP" Sh.p.k.**,

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "BRIGADA VIII" Ndertesa 23, Hyrja 4, Kati 8, Apartamenti 32, Njesia asministrative Nr.5,1019, Tirane, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.  
Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron

**AKT THEMELIMI "BUSINESS ACCOUNTING GROUP"**



veprimtarine shoqëria.

#### **NENI 4**

#### **KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

#### **NENI 5**

#### **OBJEKTI VEPRIMTARISE**

Dhenia e konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive, institucioneve publike dhe private. Ne vecanti, konsulence ligjore, fiscale, ekonomike, financiare, strategi industriale dhe ceshtje qe i bashklidhen (duke perfshire ristrukturimin dhe riorganizimin e shoqerive / ndermarrjeve), gjithashtu me sherbime konsulence ne lidhje me aleancat, joint venture, bashkimet, ndarjet, perqendrimet, blerja e shoqerive, pjesemarrje aksionere, ne shoqeri o dege shoqerishe dhe ne pune te tjera te jashtzakonshme financiare, duke bere studime dhe analiza tregu, perpunim te planeve industriale, kerkimin e partnereve strategjike, organizimin e takimeve, konferencave dhe gjithcka eshte e nevojshme me qellim zhvillimin e ketyre sherbimeve te konsulences. Ngritja e nje qendre te dhenave permes perdorimit te paisjeve elektronike dhe teknologji te perparuar ne perpunimin automatik te te dhenave, qe do te perdoret si per aktivitetet e saj dhe si nje sherbim per te tretet. Sherbime konsulence dhe asistence per nderkombetarizimin e ndermarrjeve; te siguroje ndihme teknike per institucionet dhe kompanite edhe nepermjet perpunimeve kompjuterike, si dhe mbeshtetjen elektronike 2 ne distance; trajnim profesional ne klase dhe ne distance; tregtim elektronik; studime marketingu. Per te arritur kete objekt, shoqeria mund te perdore gjithashtu edhe sherbimet e palev» te treta (te punesuar, keshilltare, anetare te tjere te shoqerise, profesioniste, agjente, perfaqesues, etj.) sipas formave, menyrave dhe metodave te percaktuara nga ligji ne fuqi. Promovimi dhe pjesemarrja ne mundesi te ndryshme investimi qe mund te paraqiten ne cdo sektor te ekonomise se vendit, duke u prezantuar si investitor i barabarte me subjekte te trete, investitor i vetem ose investitor mazhoritar me qellim arritjen e objektivave ekonomike te shoqerise dhe pjesemarrjes ne projektet me impakt social qe diktojn rritjen ekonomike te vendit dhe standartet e tij te jeteses. Shitja, posedimi, menaxhimi i letrave me vlere publike ose private, vendase dhe te huaja; kryerja e sherbimeve ne emer dhe ne



favor te personave fizike, shoqerive, konsorciume, shoqatat apo organeve te tjera, publike ose private, kombetare ose te huaj, dhe te individeve permes perpunimit te te dhenave. Procesi i perzgjedhjes per rekrutimin e stafit dhe organizimin e kurseve te informacionit, edukimit dhe trajnimit. Blerja, shitja, shkembimi, ndertimi, renovimi, menaxhimin dhe dhenia me nenqira, leasing, te pasurive te patundshme ne pergjithesi, te tipit urban dhe rural, duke perfshire ndertimin e pasurive te patundshme. Blerja, perdorimi, licencimi, per arsye te ndryshme, dhe shitja e te drejtave te pronesis se industriale te 9do lloji dhe natyre. Aktiviteti i marketingut strategjik dhe operacional dhe hulumtimit te tregut; aktiviteti i kerkimit dhe zhvillimit. Duke marre perfaqesime, mandate, te delegoje per llogari te shoqerive tregtare, industriale, ushqimore dhe sherbimeve ne pergjithesi duke marre pozicione brenda sferes se ndermjetesimit tregtare. Importeksport, prodhim e tregtim, me shumice e pakice te artikujve industrial si nafte, beznine,gaz, vaj per makina; artikujve te ndryshem ushqimor;mineraleve te te gjitha llojeve; materialeve te ndertimit; te paisjeve elektrike dhe elektronike; te mjeterve te ndryshme te transports tokesor, uxor dhe ajror si dhe pjeseve te tyre; te makinerive per prodhim ,amballazhim te te gjitha llojeve ; te paisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregtar, ushqimor, mjeksor, farmaceutik, sportiv, kulturor etj. Dhenia e kurseve praktike profesionale ne 3 fushen e kontabilitetit Dhenia e kurseve pergatitore per programet financiare, Me qellim arritjen e objektit te saj, shoqeria me vendim te organit kompetent, mund te zoteroje ne menyre te drejtperdrejte apo te tertorte pjesemarrje ne shoqeri apo ndermarrje te tjera, shqiptare apo te huaja, te aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja ne shoqeri qe per llojin e tyre nuk ofrojne pergjegjesi te kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

## NENI 6

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. MIMOZA MURATI	100,00%	100.000,00 LEKE
------------------	---------	-----------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

AKT THEMELIMI "BUSINESS ACCOUNTING GROUP"



**NENI 7**  
**AKTET E SHOQERISE**

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të percaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 8**  
**ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë “**BUSINESS ACCOUNTING GROUP**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emëruar:

**1. MIMOZA MURATI**

**NENI 9**  
**DISPOZITAT E FUNDIT**


Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane 20/01/2021**

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**“BUSINESS ACCOUNTING GROUP” SH.P.K.**

**MIMOZA MURATI**

*Mimoza Murati* 

**AKT THEMELIMI “BUSINESS ACCOUNTING GROUP”**